

SHKOLLA E MESME
“SEZAI SURROI”
BUJANOC

Profili arsimor: Elektroteknik i Kompjuterëve

Tema e Diplomës

LËNDA:

RRJETAT KOMPJUTERIKE DHE KOMUNIKIMI

TEMA:

MËSIME PËR HTML

Mentori:
Abaz Memeti, inxh.dip

Nxënësi:
Amir Miftari, IV-7

Qershor 2011



PËRMBAJTJA

MËSIMET PËR HTML (Hyper Text Markup Language)	2
<i>HYRJE NË HTML</i>	2
<i>ÇKA ËSHTË HTML</i>	2
<i>ÇFARË NA DUHET QE TË KRIJOJMË NJË HTML DOKUMENT</i>	2
<i>SI KRIJOHET DHE RUHET NJË HTML DOKUMENT</i>	2
<i>SI TË SHOHIM KODIN BURIMOR TË NJË HTML DOKUMENTI</i>	3
<i>SI TI SHOFIM NDRYSHIMET TË CILAT I KEMI BËRË NË KODIN BURIMOR TË NJË HTML DOKUMENTI</i>	5
<i>STRUKTURA BAZË E NJË HTML DOKUMENTI</i>	5
a) <i>Shkrimi dhe formatizimi themelor i tekstit</i>	7
b) <i>Përcaktimi i madhësisë së shkronjave</i>	8
c) <i>Përcaktimi i ngjyrës së shkronjave</i>	9
d) <i>Rregullimi i tekstit</i>	10
REFERENCAT	12

MËSIMET PËR HTML (HyperText Markup Language)

HYRJE NË HTML

ÇKA ËSHTË HTML?

Bashkësia e cila na ndihmon që të gjejmë të dhënat në Internet quhet **World Wide Web** (shkurtimisht: **Web**, **WWW** ose **W 3**).

Secili dokument të cilin e shohim në një Web Faqe është i shkruar në gjuhën programuese të quajtur **HyperText Markup Language** (shkurt: **HTML**).

Me qenë se HTML është një gjuhë e thjeshtë. Ne këtu do të argëtohem me ndërtimin e HTML dokumenteve dhe me shkrimin e kodeve burimore e cila punë do të na dërgoj në punimin e web faqeve përmes gjuhës HTML dhe do të na radhit në njohës të mirë të gjuhës HTML.


ÇFARË NA DUHET QE TË KRIJOJMË NJË HTML DOKUMENT ?

Për të krijuar një HTML dokument na nevojitet që të kemi të instaluar këto programe:

- shfletuesin (browserin) për shfletimin (shikimin) e HTML dokumenteve (për shembull. [Internet Explorer](#), [Netscape...](#))!
- tekst editorin më të thjeshtë për punimin e HTML dokumenteve (për shembull. [Notepad](#), Por një ndër programet më të mira është: "[Arachnophilia](#)" të cilin mund ta gjeni lehtë në internet).

SI KRIJOHET DHE RUHET NJË HTML DOKUMENT?


Në fillim hapim editorin e tekstit Notepade në këtë mënyrë: **Start-All programs-Accessories-Notepad** dhe do të shkruajmë në



```
New Text Document - Notepad
File Edit Format View Help
<HTML>
<HEAD>
<TITLE>Dokumenti im i parë në HTML</TITLE>
</HEAD>
<BODY>
Rreshti im i parë në dokument<BR>
Rreshti im i dytë në dokument...
</BODY>
</HTML>
```

pastaj klikojmë **File-Save as** dhe e ruajmë dokumentin e ri HTML. Për shembull : **hyrje.htm** ose **hyrje.html** duke e ruajtur diku në kompjuter. Secili HTML dokument ka emrin e vet të cilit i bashkëngjitet ekstensioni (prapashtesa) **.htm** ose **.html**.

Dhe në browser do të duket kështu:



SI TË SHOHIM KODIN BURIMOR TË NJË HTML DOKUMENTI?

Pasi që në browser shihni përmbajtjen e ndonjë HTML dokumenti, deri tek kodi i tij burimor mund të vini në dy mënyra:

1. - klikoni mbi dokument me anën e djathtë të miut dhe zgjidhni opsionin "[View Source](#)", dhe do hapet kodi burimor i këtij dokumenti.

Dhe do të duket kështu:

KUJDES: Kjo vlen vetëm për Internet Explorer!

Nëse përdorni **Netscape Communicator**, atëherë do të mund të shikoni vetëm kodin burimor të dokumentit por nuk do të mund të bëni ndryshime të tij. Për këtë arsye në **Netscape Communicator** duhet të zgjidhni këto opsione :

Communicator -> Composer

Edit -> HTML Source

(tani mund të ndryshoni kodin burimor të dokumentit) dhe pasi të përfundoni zgjidhni këto opsione:

Communicator -> Navigator

2. - Hapeni tekst editorin tuaj (për shembull. Notepad) dhe me ndihmën e opsioneve "File" -> "Open" ... e gjeni dhe e hapni **.html** dokumentin që dëshironi.

Provojeni këtë menjëherë në këtë mënyrë:

dhe e hapim dokumentin HTML qe e ruajtëm me parë **hyrje.html**

SI TI SHOHIM NDRYSHIMET TË CILAT I KEMI BËRË NË KODIN BURIMOR TË NJË HTML DOKUMENTI?

Pas ndryshimeve që keni bërë në tekst editorin tuaj (për shembull **Notepad**) të **.html** dokumentit, duhet që ti ruani përmes opsioneve "File" -> "Save".

Tani kaloni në browserin tuaj (për shembull: [Internet Explorer](#), [Netscape...](#)) në të cilin është lexuar [.html](#) dokumenti i njëjtë klikoni në opsionin "Refresh".

Nëse çdo gjë është në rregull do të shihni ndryshimet që keni bërë.

Nëse ndryshimet nuk i shihni, ndoshta keni gabuar gjatë shkrimit të kodit burimor të dokumentit.

STRUKTURA BAZË E NJË HTML DOKUMENTI

Pra, HTML dokumentet tuaja gjithmonë ndani nga ekstensioni [.html](#) (për shembull: [experimenti1.html](#) ose [experimenti1.htm](#)). Tani e tutje, kur filloni të shkruani në tekst editorin tuaj një HTML dokument duhet të respektoni rregullat e caktuara.

Mos të ju shqetësojnë kodet e pakuptueshme, kjo është gjuha HTML që së shpejti do jetë shumë e kuptueshme për ju...

Nën një, të gjitha HTML urdhrat duhet të jenë në mes shenjave `< ... >`

Ç'do gjë që shkruani në mes të këtyre shenjave nuk do të shihet në browser por do të trajtohet si urdhër i HTML-së.

Ç'do gjë që gjendet jashtë këtyre shenjave (për shembull: ``ky është teksti që do shifet me shkronja të trasha ``) do të duket në browser.

Shumica e urdhrave ka shenjat e fillimit dhe të përfundimit. Shenjat përfundimtare gjithmonë kanë në vete shenjen `"/`.

Për shembull: `<I>` është shenja për fillimin e shkronjave të pjerrëta, ndërsa `</I>` është shenja përfundimtare e shkronjave të pjerrëta. Kështu që gjithçka që shkruani në mes të dy urdhrave do të shihet në browser si shkrim me *shkronja të pjerrëta ...*

Urdhrat mund ti kombinoni për shembull:

... ashtu që shenjat përfundimtare vendosni në renditje të kundërt me shenjat filluese. Nën dy çdo HTML dokument duhet të ketë strukturën e caktuar:

- shenja e fillimit `<HTML>` dhe shenja e fundit `</HTML>`,
- koka `<HEAD>` `</HEAD>` në mes të cilave shënojmë opsionet themelore (të cilat nuk janë të domosdoshme)
- trupi `<BODY>` `</BODY>` në mes të cilave shënojmë ç'do gjë që dëshirojmë që të shihet në browser.

```
<HTML>  
<HEAD>  
</HEAD>  
<BODY>  
</BODY>  
</HTML>
```

Ja një shembull me sqarime (me ngjyrë të kuqe janë shënuar urdhrat e gjuhës HTML):

Kodi burimor i HTML dokumentit (si duket në Notepad) Sqarime Rezultati të cilin e shohim në browser

```
<HTML>
<HEAD>
<TITLE>Dokumenti im i parë në HTML</TITLE>
</HEAD>
<BODY>
Rreshti im i parë në dokument<BR>
Rreshti im i dytë në dokument...
</BODY>
</HTML>
```

Shenja e fillimit të HTML dokumentit

Shenja filluese e kokës

Caktimi i titullit të dokumentit

Shenja përfundimtare e kokës

Shenja filluese e trupit

teksti i cili do të shihet në browser

(
 është urdhri për përfundimin e rreshtit)

Shenja përfundimtare e trupit

shenja përfundimtare e HTML dokumentit

Rreshti im i parë në dokument...

Rreshti im i dytë në dokument...

Meqenëse çdo HTML dokument ka strukturë të njëjtë (të cilën e shihni në kolonën e parë të tabelës së më sipërme), ndërtimin e HTML dokumenteve të rinjë mund ta bëni shumë lehtë nëse këtë strukturë e ruani në një dokument të cilin do ta emëroni (për shembull: [blank.htm](#)).

Kështu kur dëshironi që të punoni një HTML dokument të ri, së pari e lexoni në tekst editor dokumentin [blank.htm](#) pastaj me opsionin "File" -> "Save As..." e riemëroni me emrin që dëshironi dhe vazhdoni të punoni në të. Kështu do i shmangeni shkrimin të urdhrave të njëjtë shumë herë.

Edhe diçka më rëndësi. Urdhrat në HTML mund ti shkruani me shkronja të mëdha dhe të vogla. Këtu nuk ka përkufizime. Megjithatë do të ishte mirë që ç'do herë të shkruani me shkronja të mëdha që më lehtë ti dalloni nga përmbajtja tjetër e dokumentit..

Mësimi 1- Bazat e HTML-së

a) Shkrimi dhe formatizimi themelor i tekstit (<H1>...<H6>, , <I>,
, <HR>)

Urdhërat HTML, Sqarime, Rezultati në browser

`<H1>eksperimenti</H1>`

përcaktimi i madhësisë së shkronjave

`<H1>` -të mëdha ...

`<H6>` -të vogla

eksperimenti

`<H6>eksperimenti</H6>`

përcaktimi i madhësisë së shkronjave **eksperimenti**

`eksperimenti`

ose `eksperimenti`

shkronjat e theksuara **eksperimenti**

`eksperimenti`

ose `<I>eksperimenti</I>`

shkronjat jo te theksuara *eksperimenti*

`
`

ndërprerja e rreshtit –

rreshti i ri -

`<HR>`

Vendosja e vijës horizontale

`<HR WIDTH="50%" COLOR="blue" ALIGN="left">`

vija horizontale me parametrat (width =gjatësia, color =ngjyra, align=hapësira)

b) Përcaktimi i madhësisë së shkronjave (`...`)**Urdhërat HTML Sqarime Rezultati në browser**

`eksperimenti`

Përcaktimi i madhësisë së shkronjave (SIZE mund të jetë 1 - 7)


Eksperimenti

`eksperimenti`

Përcaktimi i madhësisë së shkronjave



`eksperimenti`
zvogëlimi i shkronjave për 3 madhësi



`eksperimenti`

ritja e shkronjave me 3 madhësi




c) Përcaktimi i ngjyres së shkronjave (...)

Urdherat HTML Sqarime Rezultati në browser


eksperimenti

Vendosja e shkronjave me ngjyrë të kaltër (#0000FF = numri hexadecimal i ngjyrës.)




eksperimenti

vendosja e shkronjave me ngjyrë të kuqe (red = emri i ngjyres se kuqe)



`eksperimenti`

Vendosja e njëkohshme e ngjyrës së gjelbër dhe madhësisë së fontit 5




d) Rregullimi i tekstit (`<P ALIGN="left">...</P>`)

Urdhrat HTML, Sqarime, Rezultati në browser


`<P ALIGN="left">eksperimenti</P>`

vendos tekstin në anën e majtë të faqes (left = majtas)




`<P ALIGN="right">eksperimenti</P>`

vendos tekstin në anën e djathtë të faqes (right = djathtas)



`<P ALIGN="center">eksperimenti</P>`

vendos tekstin në qendër të faqes (center = qendër)



REFERENCAT

1. <http://www.ic.ims.hr/office/frontpage2003/kazalo-fp.html>
2. http://www.znanje.org/knjige/computer/html/html_prirucnik
3. http://tutoriali.org/HTML_i_CSS.html
4. <http://sq.wikipedia.org/wiki/HTML>
5. Shenime nga lënda *Rrjetat Kompjuterike dhe Komunikimi*, Bujanoc 2010/2011
6. Zoran Urošević: *Računarske Mreže i Komunikacije*, ZUNS, Beograd 2008